

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, si një institucion i arsimit të lartë, vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.

Sa më sipër, funksionet dhe detyrat e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë janë:

- Të sigurojë arsimim cilësor dhe në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të ofrojë një spektër të gjerë të programeve në fushat e ekonomisë, bujqësisë, edukimit, shkencave humane dhe natyrore;
- Të japë një kontribut të qenësishëm në zhvillimin arsimor, ekonomik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve lokale, rajonale dhe më gjerë, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit të njohura dhe të vlerësuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore, për t’u përballur denjësisht me kërkesat e tregut të punës;
- Të kontribuojë në zhvillimin rajonal e më gjerë, nëpërmjet përgatitjes së specialistëve në fushat që mbulon duke integruar më së miri kërkimin shkencor, edukimin dhe shërbimin ndaj publikut;
- Të ofrojë edukim cilësor dhe të nxitë përgatitjen profesionale dhe personale për çdo student që kërkon të ndërtojë një karrierë produktive dhe të ketë përgjegjësi sociale;
- Të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë;
- Të sigurojë kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për studim dhe kërkim shkencor;
- Të bashkëpunojë me institucionet vendase dhe të huaja në lidhje me arsimin, kërkimin shkencor, veprimtaritë krijuese dhe profesionale, etj.